

Detajet e çështjes

Nr. i çështjes: 31004-00889-86-2016

Data e regjistrimit: 26-02-2016

Palët

Paditës: Shoqëria "Projeksion Energji" sha

I paditur: Drejtoria Rajonale Tatimore Tirane, Drejtoria Apelimit Tatimor prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve, Avokatura e Shtetit

Objekti: Shfuqizimin e vendimit te Drejtorise se Apelimit Tirane njoftuar me shkresen nr 23950/3 prot date 28.10.2015 "per refuzimin e ankimit ndaj njoftim vleresimit tatimor nr 20004/13 prot date 07.07.2015 nxjerre nga DRT-Tirane pasi nuk eshte plotesuar kushti I parapagimit apo vendosjes se garancise bankare per Shumen e plote te detyrimit tatimor dhe detyrimin e Drejtorise Apelimit Tatimor Tirane te nxjerre nje vendim te perkohshem per pezullimin e procedures deri ne zgjidhjen e ceshtjeve gjyqesore qe varen nga ky process ankimi Marrja e mases se sigurimit te padise duke pezulluar zbatimin e aktit administrative nr 20004/13 prot date 07.07.2015 "njoftim vleresimi per detyrimet tatimore" mbeshtetur ne te dhenat e raportit perfundimtar te kontrollit te dates 03.07.2015 te ushtruar ne shoqerine "Projeksion Energji" sha pasi ekziston dyshimi I arsyeshem I bazuar ne dy ceshtje gjyqesore qe kesaj shoqerie mund ti shkaktohet nje dem I rende dhe I pakthyeshem

Relatori: Kastriot Selita

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr.6437 datë 21.12.2015 ka vendosur:

1. Mospranimin e kërkesë-padisë së paditësit Shoqëria "Projeksion Energji" Sha me NIPT K 71909007 J , me adresë Rr "Ali Baushi" nr.55 Tiranë,përfaqësuar nga Anastas Riska në bazë të vendimit të Asamblesë së Përgjithëshme të Aksioneve të Shoqërisë, kundër të paditurve Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, dhe Drejtoria e Apelimit Tatimor, me objekt: Shfuqizimi i vendimit të Drejtorisë së Apelimit Tatimor Tiranë, njoftuar me shkresën nr.23950/3 prot datë 28.10.2015 "Për refuzimin e ankimit ndaj Njoftim Vlerësimit nr.20004/13 prot datë 07.07.2015 nxjerrë nga DRTatimore Tiranë, pasi nuk është plotësuar kushti paraprak i pagesës apo vendosjes së garancisë bankare për shumën e plotë të detyrimit tatimor" dhe detyrimin e Drejtorisë së Apelimit Tatimor Tiranë, për të nxjerrë një vendim të perkohshëm për pezullimin e procedurës deri në zgjidhjen e çështjeve gjyqësore nga të cilat varet ky vendim ankimi.Marrja e masës së sigurimit të padisë, nëpërmjet pezullimit të zbatimit të aktit administrativ nr.20004/13 prot datë 07.07.2015 "Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore" mbështetur në të dhënat e Raportit Përfundimtar të Kontrollit të datës 03.07.2015 të ushtruar në Shoqërinë "Projeksion Energji" Sha pasi ekziston dyshimi i ardyesëshëm i bazuar në dy çështje gjyqësore që kësaj shoqërie mund ti shkaktohet një dëm i rëndë dhe i pakthyeshëm, pasi padia nuk i plotëson kushtet formale të paraqitjes së saj pasi nuk është shteruar rruga administrative sipas nenit 39/3 të ligjit nr.49/2012.

2. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.

Gjykata Administrative e Apelit, vendosi:

1. Lënien në fuqi të Vendimit Nr. 6437 (80-2015-4743), datë 21.12.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. 2. Shpenzime gjyqësore nuk ka. 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë brenda 30 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi. U shpall në Tiranë sot më datë 08.02.2017

Data e

shpalljes: 08-02-2017